# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "Albturist Albania" sh.p.k.

Personi qe e firmos me poshte:

**Fuat Shahu ,** i biri i **Reshatit** dhe i **Merjemes,** lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane, Rruga **"Vaso Pasha" Pallati Nr.24 Ap.18,** i identifikuar me pasaporte Nr.**Z0039165**, ka hartuar si me poshte **Aktin e Themelimit te nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.**

**Neni 1**

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi dhe sidomos ne ligjin 7638 ate 19/11/1992 **"Per shoqerite tregetare"**, ligjin 7667, dt 28/01/1993 " **Per rregjistrin Tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare"**, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e Statutit te Shoqerise qe i bashkangjitet ketij Akti Themelues.

**Neni 2**

Emertimi i shoqerise eshte **"Albturist Albania"Sh.P.K.** dhe do ta kete seline ne Rrugen **"Vaso Pasha"Pallati Nr.24 ap.18 Tirane**.

**Neni 3**

Trasferimi i selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e ortakut te vetem qe zoteron 100 % te kapitalit themeltar, ne momentin e krijimit te kesaj shoqerie.

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise **"Albturist Albania" Sh.P.K.** eshte :

-Veprimtari ne fushen e sherbimeve si Agjensi Udhetaresh dhe prerje biletash per linjat kombetare dhe nderkombetare, Agjensi Detare, Udhetimesh, transport pasagjeresh dhe mallrash per transport detar, ajror e tokesor. Agjensi spedicionere dhe sherbimesh portuale ne pergjithesi.

Fuat Shahu

-Organizim dhe menazhim i grupeve turistike shqipetare dhe te huaja per vizita turistike brenda dhe jashte vendit.

-Te kryeje veprimtari transporti udhetaresh ose mallrash me mjetet e saj ose te te treteve per llogari te saj ose te te treteve.

-Te organizoje koncerte dhe festa te ndryshme, udhetime, mbledhje dhe aktivitete te ndryshme.

-Shoqeria mund te marre pjese dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj qe kane te njejtin objekt veprimtarie ose te ngjashem me te.

- Shoqeria mund te zhvilloje çfaredo lloj aktiviteti tjeter te afert ose qe lidhet me objektin e saj , e vetme ose me pjesmarrje me ente, ndermarje apo shoqeri te tjera, duke kryer te gjitha operacionet financiare te nevojshme per arritjen e qellimit te Shoqerise.

Neni 5

Kapitali i Shoqerise "**Albturist Albania**"**Sh.P.K.** eshte **100.000** leke. Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se **1.000** leke.

**Neni 6**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe te pacaktuar kohe, por sidoqofte jo me pak se **30 vjet**, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykate.

**Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100 000 leke.**
Ky kapital perbehet nga kontributi i vetem i **Z. Fuat Shahu ,** i cili kontribuon **me 100 000 leke.**
Kapitali themeltar prej **100 000 leke** , eshte i eshte i pa ndare , i cili eshte i depozituar nga ortaku i vetem prane Bankes **"RAIFFEISEN BANK"** ne Tirane per llogari te Shoqerise qe krijohet.
Ortaku ka te drejte te beje zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit sipas vendimit qe merr vete ai .
Te gjithe pjeset qe formojne kapitalin themeltar , nenshkruhen, shlyhen plotesisht nga ortaku i vetem

Fuat Shahu

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifate te leshuar nga Banka ku eshte bere depozitimi ne te cilin shenohet emeri dhe mbiemeri i ortakut te vetem , pjesa e kapitalit themeltar te nenshkruar dhe te derdhura prej tij .
Themeluesi i vetem i shoqerise deklaron se shuma e derdhur prej tij eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne çertifikate dhe se ai konfirmon nenshkrimin e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumen respektive te derdhur.

**NENI 7.**

Ne marredheniet me te tretet , shoqeria tregetare " **Albturist Albania"Sh.P.K.** perfaqesohet nga **Admnistratori** i Shoqerise. .

**NENI 8**

Çdo gje qe do te kryehet parashikohet ne statutin e shoqerise , kopje e te cilit do te depozitohet ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane

**NENI 9.**

Ky Akt Themelimi eshte hartuar me 05.12.2005 ne Tirane ne kater ekzemplare origjinale, ne gjuhen shqipe duke patur te gjithe fuqi te barabarte ligjore.

**ORTAKU I VETEM**

FUAT SHAHU

# S T A T U T
# I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## " Albturist Albania" sh.p.k.

Ne mbeshtetje te Ligjeve te Republikes se Shqiperise Nr.7667 **dt.28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare"** dhe Nr.**7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare "** une **Fuat Shahu, i biri i Reshatit dhe i Merjemes,** lindur ne **Sarande** dhe banues ne **Tirane**, Rruga **"Vaso Pasha" Pallati Nr.24 Ap.18** Tirane, i identifikuar me pasaporte Nr.**Z0039165**, themelues i **Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Albturist Albania"**, ortak i vetem hartoj statutin e shoqerise.

**I.DISPOZITA TE PERGJITHESHME :**

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Albturist Albania" Sh.P.K.**, eshte person juridik i te drejtes shqipetare e themeluar nga ortaku i vetem Z.**Fuat Shahu**, qytetar shqipetar dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, e cila e ushtron aktivitetin e saj ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, dt. 19.11.1992 **"Per Shoqerite Tregetare"**, Ligjit Nr.7667, dt. 28.01.1993 **"Per Rregjistrin Tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare"**, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e ketij statuti.

Neni 2

Shoqeria e ushtron aktivitetin ne baze te dispozitave te Aktit te themelimit te ketij Statuti dhe Ligjeve te Ekonomise te Tregut te Lire.

Neni 3

Ortaku i vetem themelues i Shoqerise ne kete sipermarje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitoje nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Fuat Shahu

Neni 4

Shoqeria **"Albturist Albania" Sh.P.K.** eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin si person juridik ne **Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.**

Neni 5

Emeri i shoqerise eshte **"Albturist Albania"Sh.P.K**. dhe ka vulen e saj me permbajtjen **"Albturist Albania" Sh.P.K**. Selia e shoqerise eshte ne Tirane ne rrugen **"V.Pasha" P.24 Ap.18 Tirane**. Shoqeria ka te drejte te krijoje, transferoje apo ta suprimoje adresen simbas nevojave te saj.

Neni 6

Afati i zgjatjes se veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar kohe, por jo me pak se **30 vjet** nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar. Ortaku i vetem mund te vendose zgjatjen e ketij afati, ose zgjidhjen e parakoheshme te Shoqerise.

**-II-OBJEKTI I VEPRIMTARISE :**

Neni 7

Objekti i veprimtarise zhvillohet ne ato fusha qe jane permendur ne Aktin e Themelimit dhe konsiston ne :

-Veprimtari ne fushen e sherbimeve si Agjensi Udhetaresh dhe prerje biletash per linjat kombetare dhe nderkombetare, Agjensi Detare, Udhetimesh, transport ,sagjeresh dhe mallrash per transport detar, ajror e tokesor. Agjensi spedicionere dhe sherbimesh portuale ne pergjithesi.

-Organizim dhe menaxhim i grupeve turistike shqipetare dhe te huaja per vizita turistike brenda dhe jashte vendit.

-Te kryeje veprimtari transporti udhetaresh ose mallrash me mjetet e saj ose te te treteve per llogari te saj ose te te treteve.

-Te organizoje koncerte dhe festa te ndryshme, udhetime, mbledhje dhe aktivitete te ndryshme.
-Shoqeria mund te marre pjese dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj qe kane te njejtin objekt veprimtarie ose te ngjasheme me te.

- Shoqeria mund te zhvilloje çfaredo lloj aktiviteti tjeter te afert ose qe lidhet me objektin e saj , e vetme ose me pjesmarrje me ente, ndermarje apo shoqeri te tjera , duke kryer te gjitha operacionet financiare te nevojshme per arritjen e qellimit te Shoqerise.

Neni 8

Kapitali i Shoqerise "Albturist Albania" eshte 100.000 leke. Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1.000 leke.

## -III- DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 9

Shoqeria "**Albturist Albania" Sh.P.K.** eshte person juridik shqipetar dhe personalitetin juridik e fiton diten e rregjistrimit ne **Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane** ne rregjistrin tregetar. Veprimtarine e saj e ushtron pasi rregjistrohet ne organet tatimore dhe paiset me lejen e ushtrimit te veprimtarise. Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendimet e tij rregjistrohen ne librin e shoqerise.

Neni 10

Ortaku i vetem ne pershtatje me nenin Nr.61 te Ligjes Nr.7638 ne drejtimin e shoqerise se krijuar prej tij ka po ato te drejta qe ky ligj i njeh Asamblese se Ortakeve. Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e tij.

Neni 11

Ortaku i vetem duhet te kryeje depozitimin e kapitalit themelor, per llogari te shoqerise ne formim te nje noter apo tek ndonje banke.

Neni 12

Ndryshimet ne objektin e veprimtarise si dhe çdo ndryshim tjeter ne Aktin e Themelimit dhe Statutit behet nga ortaku i vetem konform Nenit Nr.61 te Ligjit Nr.7638 **"Per Shoqerite Tregetare"**

Neni 13

Ortaku i vetem mund te kaloje pjese te kuotave te tij respektive personave te tjere, ne perputhje me rregullat e parashikuara ne Ligjin Nr.7638, dt.19.11.1992 **"Per Shoqerite Tregetare"**

**-IV-Drejtimi Administrativ :**

Neni 14

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Albturist Albania" Sh.P.K.** administrohet nga nje ose disa persona fizike.Administrator mund te jete dhe Ortaku I Vetem ose Mund te emerohet me vendim te tij nje person tjeter . Ne rast se ortaku i vetem nuk vendos ndryshe, Administratori emerohet per tere periudhen e egzistences se shoqerise. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrdhenie me te tretet, ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe Ligja ja jep shprehimisht Ortakut te vetem.

Neni 15

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai kryen te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe eshte pergjegjes individualisht ndaj te treteve dhe shoqerise per shkelje te ligjeve, Statutit apo per shkelje te tjera te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 16

Ne marrdhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori. Administratori shkarkohet me vendim te ortakut te vetem. Çdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefeshme. Ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejta, ai le shkak per demshperblim financjar qe duhet te zgjidhet simbas dispozitave ne fuqi.

**-IV-MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCJARE :**

Neni 17

Operacionet financjare te Shoqerise kontabilizohen ne perputhje me Ligjin "Per Kontabilitetin" si dhe dispozitat e tjera ne fuqi. Veprimtaria ekonomiko-financjare e shoqerise mbyllet ne fund te vitit kalendarik. Ne fund te çdo viti financiar Ortaku i vetem ose personi i ngarkuar prej tij jane te detyruar te paraqesin prane organeve perkatese bilancin vjetor duke bere edhe nje raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit finacjar.

Neni 18

Shoqeria ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave shqiptare ose te huaja.

Neni 19

Shoqeria ka te drejte te marre kredi nga bankat shqiptare, te huaja apo personat private. Ajo per sigurimin e veprimtarise ekonomike ka te drejte te financohet ne leke ose valute te huaj.

Neni 20

Çmimet dhe tarifat me te cilat do te operoje ne tréġ shoqeria do te caktohen konform ligjeve ne fuqi sipas kerkeses dhe ofertes.

**-V-MAREDHENIET E PUNESIMIT :**

Neni 21

Ortaku i vetem apo Administratori vendos konform dispozitave ne fuqi per personat e tjere qe do te punesohen ne shoqeri.

Neni 22

Marrdheniet e punesimit ne shoqeri rregullohen sipas dispozitave ligjore qe normojne veprimtarine e punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 23

Paga per personat e punesuar ne Shoqerin "Albturist Albania" Sh.P.K. caktohet sipas kontrates se punes.

**-VI-PERFUNDIMI I AKTIVITETIT :**

Neni 24

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet :

a) Me kalimin e afatit te fiksuar per kohezgjatjen e saj.
b) Per pamundesine e realizimit te objektit te shoqerise.
c) Me vendim te ortakut te vetem

Neni 25

Likujdimi i shoqerise do te behet simbas normave te legjislacjonit shqipetar ne fuqi ne ate kohe. Ortaku i vetem do te percaktoje modalitetet e likujdimit dhe do te emeroje nje ose me shume likujdatore, duke percaktuar fuqite e tyre dhe shperblimin. Ne rast te zgjidhjes se shoqerise mbetja eventuale, sapo te paguhen te gjitha pasivitetet, i takojne ortakut te vetem.

**-VII-DISPOZITA TE FUNDIT :**

Neni 26

Shtimi i numerit te ortakeve behet duke respektuar te gjitha kerkesat e Ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 "**Mbi Shoqerite** Tregetare"

Neni 27

Lidhur me mosmarrveshjet eventuale qe mund te lindin gjate aktivitetit te shoqerise kane fuqi Ligji Nr.7764, dt. 02.11.1993 "**Mbi investimet e huaja**", Ligji Nr.7638, dt. 19.11.1992 "**Mbi Shoqerite Tregetare**" si dhe normat e perfshira ne Aktin e Themelimit te shoqerise dhe ne Statutin ne fjale. Per te gjitha konfliktet qe rrjedhin nga ky Statut eshte kompetente Gjykata e Shkalles se Pare ne vendin ku shoqeria e ka seline. Per problemet qe nuk kane te bejne me Rregjistrin Tregetar Shoqeria mund t'ju drejtohet Gjykatave te Rretheve te tjera apo edhe te shteteve te tjera.

Neni 28

Per sa nuk eshte shprehur ne kete Statut do te zbatohen te gjitha dispozitat e shprehura ne legjislacjonin shqiptar apo ne Aktet e tjera normative duke ju referuar ligjeve te veçanta, qe kane qene ne fuqi per kohen kur ato kane ndodhur. Ne rast se dispozita te veçanta te ketij statuti behen te pavlefeshme ose kane boshlleqe, kjo nuk prek vlefshmerine e dispozitave qe mbeten. Ne keto raste eshte e vlefeshme ajo dispozite qe eshte ne frymen dhe qellimin e ketij Statuti.

Neni 29

Ky Statut eshte hartuar me 05.12.2005 ne Tirane ne kater ekzemplare origjinale, ne gjuhen shqipe duke patur te gjithe fuqi te barabarte ligjore.

**ORTAKU I VETEM**

FUAT SHAHU